


Statistikat Tregtare të Kosovës, Tregtia e jashtme e mallrave, eksporti-importi me Greqinë

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shkëmbimi tregtar me Greqinë¹, për vitin 2025, deficitin tregtar ka shënuar një përmirësim prej 12.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, duke u zvogëluar në -269.5 milionë euro nga -308.8 milionë euro sa ishte në 2024. Mbulueshmëria e importit nga eksporti është rreth 3.4%.

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave me Greqinë sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Tabela 1. Bilanci tregtar i mallrave në milionë euro, në % mbulueshmëria dhe rritje (v-m-v)

Viti	2022	2023	2024	2025
Eksport	5.0	6.4	6.5	9.5
Import	307.3	301.2	315.4	279.1
Bilanci tregtar	(302.4)	(294.8)	(308.8)	(269.5)
% e mbulimit	1.6%	2.1%	2.1%	3.4%
Rritje Exp. (v-m-v) %	19.5%	29.3%	1.9%	46.1%
Rritje Imp. (v-m-v) %	50.5%	-2.0%	4.7%	-11.5%
Bila. Treg. (v-m-v) %	51.2%	-2.5%	4.8%	-12.7%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

¹ Greqia, zyrtarisht Republika Hellenike, është një vend në Evropën Juglindore, në gadishullin Ballkanik, me kryeqytet Athinën. Ka një sipërfaqe prej 131,957 km², me rreth 10.3 milionë banorë. Bruto Prodhimi Vendor (GDP) nominal për vitin 2025 vlerësohet rreth 280 miliardë \$ (dollar amerikan), me të ardhura për kokë banori (per capita) rreth 27,041 \$ (dollar amerikan), e renditur si ekonomia e 50-të më e madhe në botë nominalisht sipas FMN-së.

Analizuar në periudhën e fundit marrëdhëniet tregtare të mallrave ndërmjet Kosovës dhe Greqisë karakterizohen nga një deficit i vazhdueshëm tregtar në favor të Greqisë gjatë periudhës 2022–2025.

Gjatë kësaj periudhe Eksportet e Kosovës me Greqinë kanë shënuar një rritje nga 5.0 milionë euro në vitin 2022 në 9.5 milionë euro në vitin 2025 (me një rritje të lartë prej 46.1% në vitin e fundit). Ndërsa te Importet vërejmë luhatje, nga një pikë prej 315.4 milionë euro në vitin 2024, rënie e ndjeshëm me -11.5% në vitin 2025, në 279.1 milionë euro.

Si rezultat i këtij trendi vitet e fundit, ky kombinim i rritjes së eksporteve dhe rënies së importeve solli përmirësim të bilancit tregtar dhe rritjen e shkallës së mbulimit në 3.4% në vitin 2025.

Megjithëse mbulueshmëria ka shënuar një rritje nga 2.1% në 3.4% brenda një viti, hendeuku tregtar mbetet i thellë, gjë që kërkon politika më agresive për nxitjen e eksporteve të produkteve me vlerë të shtuar. Importet nga Greqia (në sasi dhe në vlerë) dominojnë dukshëm ndaj eksporteve të Kosovës, duke reflektuar varësinë relativisht të madhe të tregut kosovar nga produktet greke.

Figura 2. Eksport/Importi me Greqinë sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)


Gjatë vitit 2025 vlera e mallrave të eksportuara për në Greqi ishin rreth 9.5 milionë euro apo 1.0% si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm.

Importet e mallrave nga Greqia arritën në 279.1 milionë euro apo 4.0% si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm, renditet e shtata në listën e 10 vendeve kryesore të importet.

Struktura e Eksportit/Importit me Greqi në 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve

Sipas të dhënave nga Open_DATA Doganat e Kosovës(DK) për vitin 2025 grupet kryesore të Eksportit e përbëjnë: 28.9% Artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi; 27.8% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 19.9% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 5.4% Produkte të industrisë kimike; 3.7% Mjetet e transportit; 3.3% Artikuj të ndryshëm të prodhuara (mobileri, krevat, dyshek, jastëk etj); 3.3% Produkte bimore etj. si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm me Greqinë.

Figura 3. Struktura e Eksportit 2024-2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)


Rritja e eksporteve për 46.1% apo rreth 3.0 milionë euro më shumë mallra në tregun grek në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja te sektorët si, Artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi (nga 24.7% në 28.9), te Mjetet e transportit (nga 1.7% në 3.7%) dhe te Produkte bimore (nga 1.6% në 3.3%).

Eksportet e Kosovës drejt Greqisë karakterizohen nga një përqendrim i lartë, ku vetëm tre sektorët kryesorë (artikujt prej guri, allçie, keramike., plastika dhe metalet bazë) përbëjnë rreth 76.8% në vitin 2024 dhe rreth 76.6% në vitin 2025 të vlerës totale të eksportuar. Ky përqendrim i lartë në vetëm tre sektorë (mbi 76%) e bën bilancin e eksporteve kosovare mjaft të ndjeshëm ndaj luhatjeve të çmimeve në tregjet ndërkombëtare të plastikës dhe metaleve.

Te Importet për vitin 2025, kemi këtë renditje të sektorëve-grupe kapitujve kryesor si në vijim: 61.5% Produkte minerale; 8.6% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 8.5% Produkte të

industrisë kimike; 6.2% Produkte bimore; 5.1% Ushqimet e përgatitura, pije, pije alkoolike dhe duhani; 1.9% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 1.9% Letër dhe artikuj prej letëre etj. si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm nga Greqia.

Figura 4. Struktura e Importit 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rënia e importeve për 11.5% apo rreth 36.3 milionë euro më pak mallra te importuara në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rënia e sektorëve si Produkte minerale (nga 66.7% në 61.5%) dhe te Metalet bazë dhe artikujt prej tyre (nga 9.9% në 8.6%).

Dominimi i produkteve minerale me rreth 66.7% në vitin 2024 dhe rreth 61.5% në vitin 2025 të vlerës totale në strukturën e importeve, tregon varësinë e vazhdueshme të tregut dhe industrisë kosovare nga këto prodhime industriale greke. Dominimi i produkteve minerale (si lëndet djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e destilimit prej tyre, substancat bituminoze, dyllet minerale si dhe kripërat, sulfuret; materialet suvatuese, gëlqere dhe çimento) me mbi 60% të importeve totale rritet nevojën për diversifikimin e burimeve të furnizimit me lëndë të parë dhe energji, për të reduktuar ekspozimin ndaj një tregu në këtë sektor strategjik.